



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 999/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Levizja Vetevendosje (LVV) paraqitur kundër Kryesuesit të Vendvotimit me nr 1904/08 për shkak të parregullsive gjate procesit zgjedhor ne raundin e dyte te zgjedhjeve lokale , në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Levizjes Vetevendosje (LVV) dega ne Prishtine .

**Arsyetim**

PZAP-i, më datë 02.12.2013 ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Levizja Vetevendosje (LVV), në të cilën theksohet se ne vendvotimin 1904/08 komisioneri i LVV-se Leart Gashi ka pare se ne listen perfundimtare te votusve ne kete vendvotim ka munguar faqja 34 e listes perkatese.Komisioneri i LVV-se ka evidentuar kete parregullsi ne Librin e votimit prane 1904/08.Duke qene se LPV-ja eshte kualifikuar si material i ndishem zgjedhor, dhe eshte dokumenti kryesor i cili konstaton vijueshmerine dhe numrin ekzakt te votuesve ne nje vendvotim, si dhe eshte dokumenti kryesor lidhur me konstatimin e perputhshmerise se rezultateve, numrit te fletvotimeve te pranuar dhe te dorezuara. Ne kete menyre, mungesa e nje faqeje te LPV-se demton rende procesin zgedhor e sidomos ate te votimit e qe ndieshem ka ndikim ne rezultatin zgjedhor. Andaj konsiderojme qe PZAP-i ne baze te pretendimeve te parashtruara ne kete ankesa dhe deshmise se dhene te komisionerit te LVV-se si dhe shiqimit te materalit zgjedhor, te urdheron rivotim ne kete vendvotim.Kesaj ankesa do ti bashklidhet deshmia ne forme te shkruaar nga komisioneri i LVV-se.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i konstatoi se nga deshmite e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se eshte penguar procesi Zgjedhor , PZAP-i i vlerëson si pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së,si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr. 999/2013 më datën 04.12.2013

Kryesuesi i Panelit  
Muharrem Shala



***Këshillë Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*